Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY

REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT / TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKI
Nr. 278/20
Datë/Datum 12.05.20
PRISHTINË - PRIŠTINA

RAPORTI I EKSPERTIT SHQYRTUES

Muhamet Kurtishaj	**08.05.2020**	**12.05.2020**	**Nr.278/20**
Emri dhe Mbiemri i eks. Shqyrtues dhe nënshkrimi	Data e autorizimit të ekspertit	Data e dorëzimit të raportit	Nr. i lëndës

BAZA LIGJORE E SHQYRTIMIT

Me datën: 04.05.2020, OE "**Kosto One**"- Suharekë, ka parashtruar ankesë me **nr.278/20**, kundër njoftimit për **dhënie** të kontratës, lidhur me aktivitetin e prokurimit **"Vlerësimi i pasurive të Paluajtshme dhe të luajtshme për KRM "Ekoregjioni" SH.A-Prizren"** me nr. KRMP-19-9690-2-3-6, iniciuar nga autoriteti kontraktues **KRM "Ekoregjioni" Sh.A.**

Autoriteti kontraktues ka zbatuar procedurë të **hapur**, negociuar, kufizuar, lloji i kontratës: punë, furnizim, **shërbime**, vlera e parashikuar e kontratës: **9.990,00 €.**
Nëse është e përsëritur ankesa, të shënohet se lidhur me këtë lëndë është nxjerr një vendim i mëparshëm i OSHP-së, më Nr.144/20

Konform nenit 113, 114 të Ligjit Nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/ L-068, dhe Ligjin 05/ L-092, Eksperti Shqyrtues i ka shqyrtuar pretendimet ankimore të OE ankues.

DISPOZITAT E SHKELURA DHE PRETENDIMET ANKIMORE

(Të përshkruhen dispozitat e shkelura dhe vetëm pikat e ankesës).

- Neni 6 i LPP-së – Ekonomiciteti dhe Efikasiteti

- Neni 7 i LPP-së – Barazia në Trajtim/Jo Diskriminimi.

- Neni 59 i LPP-së – Ekzaminimi, vlerësimi dhe krahasimi i tenderëve

Pretendimet ankimore te parashtruara ne ankesën e deponuar ne OSHP, janë/nuk janë te njëjta.
OE i propozuar për kontratë nuk ka plotësuar kushtet si fitues, nuk është i përgjegjshëm sepse fillimisht ky OE në certifikatën e biznesit nuk ka një përshkrim të aktivitetit që lidhet me patundshmëri dhe kjo është në kundërshtim m e kërkesat e FDT-së.

Me kërkesat AK ka lejuar që një kompani e cila nuk merret fare me këtë lloj shërbimi të rangohet si i përgjegjshëm dhe të shpallet fitues. OE "Eko term" siç shkruan në përshkrimin e aktiviteteve është kompani që merret me suvatim dhe punë ndërtimore e jo me patundshmëri.

KRITERET PËR VLERËSIM

Të vendosen vetëm kërkesa/kriteret që kanë të bëjnë me arsyet e eliminimit dhe / apo ato kërkesa që lidhen me pretendimet ankimore.

Nuk është përmbushure kërkesa e dosjes së tenderit sepse nuk ka përshkrimin e veprimtarisë ne certifikatën e regjistrimit te biznesit.

RAPORTI I KOMISIONIT VLERËSUES

Duke u bazuar në raportin e vlerësimit, komisioni vlerësues ka konstatuar si në vijim:
(Të përshkruhet vetëm vlerësimi i ofertës së OE ankues /ofertave, për të cilat OE ankues ka pretendime ankimore).

OE ankues ka përmbushur te gjitha kërkesat e dosjes së tenderit.

INFORMACIONET SHTESË TË MARRA ME ANË TË SQARIMEVE TË KERKUARA NGA E EKSPERTËVE SHQYRTUES DHE / OSE TEKNIK

Nuk ka marre eksperti shqyrtues informacion shtese.

VLERËSIMI SIPAS NENIT 4.1.26 TË LPP-së

(Të jepet një vlerësim se OE ankues është apo nuk është palë me interes sipas nenit 4.1.26).

OE ankues është pale e interesit ne këtë aktivitet te prokurimit.

VENDIMET E MËPARSHMETË PSH-së LIDHUR ME RASTET E NGJASHME

(Të sqarohet nëse për rastin e njëjtë është dhënë vlerësim tjetër).

Ka pasur vendim te me hershem për këtë aktivitet te prokurimit me nr.144/20.

ARSYETIMI PËR DEVIJIM NGA PRAKTIKA E MËPARSHME

(Të sqarohet për rastin se pse është devijuar nga praktika e mëparshme).

Nuk kemi devijim nga praktikat e me hershme.

PËRGJIGJE NË PRETENDIMET ANKIMORE TË OE ANKUES "Kosto One"- Suharekë

Përgjigje në Pretendimi nr.1

Lidhur me pretendimin e OE ankues se autoriteti kontraktues ka bërë shkelje të nenit 6, 7 dhe 59 të LPP-së sepse ka rekomanduar për kontratë OE i cilin nuk është i përgjegjshëm sepse në çertifikatën e biznesit nuk e ka përshkrim të aktivitetit që lidhet me patundshmëri dhe kjo është në kundërshtim me kërkesën e FDT, OE fitues në përshkrimin e aktiviteteve të veprimtarisë së kompanisë, ka suvatimin dhe punët ndërtimore e jo patundshmëritë, eksperti shqyrtues ka këtë mendim.

Në çertifikatën e regjistrimit të biznesit të OE fitues, aktiviteti kryesor i biznesit është "Punime Suvatimi" edhe në aktivitetin sekondar dhe aktivitetet e tjera, nuk ka përshkrim me aktivitete për pasuri të paluajtshme, respektivisht patundshmërive. Meqenëse kërkesa në FDT ka të bëjë me regjistrimin si OE në regjistrin profesional me dëshmi për informata për biznesin, atëherë OE i rekomanduar për kontratë nuk posedon informata për aktivitetet që ushtrohen në këtë veprimtari që lidhet me aktivitetin e prokurimit të AK-së. Prandaj ky pretendim ankimor i OE ankues është i **bazuar**.

MENDIMI I EKSPERTIT SHQYRTUES

Autoriteti kontraktues me rastin e rivlerësimit te ofertave, nuk ka respektuar në tërësi kërkesat e dosjes së tenderit sidomos gjatë krahasimit te ofertave.
Është rekomanduar për kontratë operatorin ekonomik i cili sipas çertifikatës së regjistrimit të biznesit nuk ka asnjë aktivitet të veprimtarisë së biznesit që merret me lëmine e këtij aktiviteti të prokurimit, ndërsa OE ankues sipas çertifikatës së regjistrimit të biznesit, aktivitet kryesor të biznesit ka patundshmëritë dhe menaxhimin e tyre.

Nga kjo rezulton se AK nuk ka respektuar në tërësi dispozitat e nenit 7 të LPP-së për barazi ne trajtim dhe jo diskriminim dhe nenit 59 të LPP-së që thotë se, AK do të konsiderojë një tender si të përgjegjshëm vetëm nëse tenderi në fjalë është në përputhshmëri me të gjitha kërkesat e parashtruara në njoftimin e kontratës dhe në dosjen e tenderit.
Si përfundim të këtij raporti, mbi bazën e të dhënave të konstatuara më lartë, eksperti shqyrtues i propozon panelit shqyrtues që ankesa e OE ankues të **aprovohet** si e **bazuar**.

Eksperti shqyrtues në përputhje me nenin 114 pika 2 të LPP-së, rekomandon autoritetin kontraktues që të bëjë **Rivlerësimin** e ofertave për aktivitetin e prokurimit **"Vlerësimi i pasurive të Paluajtshme dhe të luajtshme për KRM "Ekoregjioni" SH.A-Prizren"** me nr. KRMP-19-9690-2-3-6 në bazë të dispozitave të LPP-së dhe kërkesave të dosjes së tenderit.

Raporti i ekspertizës ti dorëzohet:

- Autoritetit Kontraktues - KRM "Ekoregjioni" SH.A-Prizren"
- Panelit Shqyrtues - OSHP.
- OE ankues - "Kosto One".